



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora**

---

**Në Stamboll u mbajt paneli “Marrëdhëniet shqiptaro-turke gjatë historisë”**

Në Qendrën Kulturore të Kosovës në Stamboll u mbajt paneli me temën “Marrëdhëniet shqiptaro-turke gjatë historisë”.

Në këtë panel diskutimi morën pjesë ministri i Diasporës, z. Ibrahim Makolli, dr. Nuray Bozbor, pedagoge në universitetin shtetëror “Marmara”, dhe përfaqësuesit e shoqatave shqiptare në Stamboll.



Znj. Nura foli për marrëdhëniet shqiptaro-turke gjatë periudhës së Perandorisë Otomane. Ajo tha se marrëdhëniet shqiptaro-turke, edhe pse kohë pas kohe ka pasur konflikte ndërmjet dy popujve, në përgjithësi kanë qenë shumë të mira. Perandoria Otomane ka pasur një besim të madh te shqiptarët, kështu që ata kanë arritur të marrin detyra në nivelet më të larta shtetërore deri te sadriazem ( kryeministër i sotëm ), vali, pashallarë etj.

Në fjalën e tij, ministri Makolli i vlerësoi lart marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe turqve, duke theksuar: “Shprehim mirënjohjen e institucioneve dhe të qytetarëve të Kosovës për përkrahjen që shteti dhe populli turk i kanë dhënë dhe po i japin Kosovës në fusha dhe kohë të ndryshme. Niveli i bashkëpunimit ndërmjet popullit të Kosovës dhe atij të Turqisë shënon fuqizimin dhe avancimin e marrëdhënieve mes dy vendeve dhe popujve tanë”.

Me rastin e mbajtjes së këtij paneli, ministri Makolli e bëri hapjen e uebfaqes së Qendrës Kulturore të Kosovës, nëpërmjet së cilës mund të mësohet edhe gjuha shqipe.